

VEÇORI PSIKOLOGJIKE E SOCIALE TË SERVILËVE

Servilët janë grupi më i bezdisshëm dhe më i neveritshëm i shoqërisë. Pa bërë përgjithësime, servili, siç thotë profeti Muhamed, “...është njeriu më i lig, pasi jetën e tij e përdor për të bërë vepra të liga.”⁶²

1. Disa karakteristika të servilit

Ajo që i veçon servilët nga njerëzit e ndershëm, të shkolluar dhe të kualifikuar, punëtorë dhe fjalëpakë, është fakti se ata, në shumicën dërmuese, shfaqen si të tillë hapur para opinionit, pasi, kur ekspozohen, ndihen “më shumë krenarë” para të tjerëve. Natyrisht, në sensin më negativ të fjalës. Servilëve u qeshin më shumë sytë, bëhen më të gjallë dhe më dinamikë, motivohen së brendshmi për të bërë punë të liga, e tejkalojnë shkallën e vetëpëlqimit dhe të vetëvlerësimit, mundohen të imitojnë mënyrën e sjelljes dhe të komunikimit si shefi i tyre aktual, ndodh që edhe flasin në emër të shefit dhe u premtojnë të tjerëve për zgjidhjen e një problemi që mund të kenë, pavarësisht se kryetari i tyre nuk i kanë dhe nuk mund t’i kenë autorizuar ata.

Sapo e zë mik shefin, me metoda komprometuese dhe nga më të ligat, servili shfaqet ndryshe në opinionin e gjerë shoqëror, nuk është më ai i pari që nuk e kishte mik shefin. Tani ai vendos raporte të tjera marrëdhëniesh edhe me njerëzit e tij, pasi të tjerët i duken tepër të vegjël. I shikon ata nga larg, distancohet prej tyre dhe merr pamjen e një burraveci. E shton masën e mospërfilljes

61 Pedagog i psikologjisë

62 Imami Vehbi Ismaili, “ Muhamedi, profeti Islam.” Prishtinë, 1985, fq. 100 – 101

ndaj të tjerëve, i duket sikur shkel me këmbë këdo që nuk i bindet atij dhe shefit, të cilit i ngjitet tërë ditën mbrapa. Shokët dhe shoqet, njerëzit e tjerë dhe bashkëqytetarët tashmë i shikon me sy tjetër, me syrin që, për sa kohë “e ka zënë për fyti shefin”, edhe ai ka forcë për të bërë mirë ose keq. Me qëndrime e sjellje të tilla, me veprime prej mashtruesi klasik, ai përpiqet dhe ia arrin në një masë të caktuar të kultivojë frikën tek të tjerët, sidomos tek të dobëtit dhe tek ata me botë të varfër shpirtërore dhe emocionale. Rrjedhimisht, rrethi i servilëve vjen duke u rritur. Për pasojë, ndotja e ambientit social do të vazhdojë.

Roli ndikues negativ i servilit ishte më i madh në kohën e diktaturës, ku, në kushtet e pronës së të gjithëve dhe të askujt, mungonin alternativat për të garantuar mjetet e jetesës. Ndoshte që “mëkëmbësi” i drejtorit ose i kryetarit, në rastin tonë ai që ishte më afër tyre, luante edhe rolin e ndërmjetësit e pse jo edhe të sekserit “për të bërë punë të mira” për vete, shefin dhe njerëzit e tij. E njëjta situatë vazhdon edhe sot. Ndoshta më me intensitet dhe më hapur se më parë.

Servili, për sa kohë ky apo ai drejtues është në pushtet, i shkon atij tërë ditën prapa, është gati të sakrifikojë nga shëndeti i tij dhe i familjes, mjafton që shefi i sotëm të mos ftohet, të mos sëmuret!

Servilizmi nuk njih moshë. Ndoshta për arsye të kultivimit të kësaj të keqe kaq të madhe, një pjesë e mirë e tyre, që mbartin këtë cilësi tejet negative, i përket edhe moshës së tretë!

E pabesueshme, por e vërtetë. Ata, për të “bërë karrierë!”, tjetërsohen, bëhen të vegjël shpirtërisht, tinëzarë e lajkatarë. Në më të shumtën e rasteve, këta individë janë edhe me shkollim e kualifikim të lartë. Rrjedhimisht, kërkojnë ta mbyllin jetën e tyre në poste të rëndësishme drejtuese. Sapo këta njerëz së paku mendojnë se drejtorët dhe shefat e tyre kanë njëfarë simpatie për ta, flasin me termat dhe togfjalëshat e drejtuesve të tyre. Humbasin kështu identitetin, dyzohen moralisht e shpirtërisht, kthehen të gjithë në tipat e Fushesë të Cvajkut të madh, nobelistit të njohur të shekullit të kaluar. Personazhe të tilla nuk ndalen para asgjëje, mjafton që të jenë gjithnjë në anën e fitimtarëve. Për të arritur qëllimet e tij të fëlliqura, për të mbuluar inferioritetin e tij kulturor dhe profesional, servili nuk pyet as për integritet

moral, as për pabesi ndaj të tjerëve, as për mburrje e intriga. Në të vërtetë, ai është një Jago shekspirian, për të cilin mund të thuash ç'të duash, mund t'i vendosësh çdo lloj epiteti negativ dhe nuk ke thënë asgjë.

Servili kërkon të përfitojë sa më shumë pa punuar, pa u lodhur, pa u djersitur, pavarësisht se është me një shkollim të ulët dhe pa një kontribut të spikatur profesional dhe politik. Ai bën gjithë ditën marketing për drejtorin e tij, kërkon të rregullojë në punë, përmes titullarit, edhe njerëzit e vet, ndonëse edhe ata nuk kanë asnjë lloj meritokracie dhe asnjë njohje për punë të mirë në komunitet apo institucion. Në të vërtetë, ata shpeshherë ia arrijnë qëllimit. Bëhen edhe zyrtarë të pashkolluar dhe të pakualifikuar. Servilët dhe të pashkolluarit e vërtetë kanë edhe njëfarë mbështetjeje politike. Zënë edhe vende punë drejtuese me peshë, por që nuk e kanë aftësinë për t'i shërbyer vërtet komunitetit. Aq më tepër sot, kjo po kthehet në një sindromë me shumë pasoja për të ardhmen e vendit, për zhvillimin e rrethit apo të qarkut që ata përfaqësojnë. E dhimbshme dhe e trishtueshme por e vërtetë: sot ka ardhur koha e Zylove të romanit të viteve '70 – të shkrimtarit të njohur Dritëro Agolli. Në mos, situata është edhe më keq. Tipa të tillë janë gjithnjë me fitimtarët, me atë forcë politike që, si rregull, është gjithnjë në pushtet. Sot zyrat e shtetit dhe institucionet e tij mbajnë jo pak "intelektualë" të këtij niveli. Argumenti i paargumentuar i të qenit nëpunës sipas këtyre zyrtarëve qëndron në shumë raste në "kontributin politik" të fitores së kryetarit apo drejtorit të tij. Ndodh që ëndërrime të tilla i bën publike pas përfundimit të zgjedhjeve, paçka se ai, me formatin e kufizuar moral që ka, me gjysmë shkollimi të dyshuar, që mund të ketë kryer dhe me sjelljen e tij në familje dhe në komunitetet, mundet që më shumë i largon votuesit, sesa i ofron ata. Jo vetëm kaq, por krijon për shefin një perceptim të gabuar edhe në opinion, kur e shikon atë të shoqërohet tërë ditën me servilin, qenien më zvarranike dhe më gjynahqare të shoqërisë.

Duam apo nuk duam ta pranojmë, njerëz të tillë, me sjellje e qëndrime të kësaj natyre ndaj politikanit, drejtorit apo shefit të tyre, përfitojnë në kurriz të të shkolluarve të vërtetë dhe intelektualëve në tërësi. Duke pasur vetëm teserën e partisë,

ndonëse nuk ka fare bindje për këtë apo atë program të forcave të ndryshme politike dhe duke poseduar “pasaportën” e servilizmit, servilin e gjen një ditë të bukur në një zyrë që nuk ka lidhje me zanatin dhe shkollimin e tij dhe që natyrisht nuk i përgjigjet atij me formimin kulturor që ka. Të tillë tipa “i kanë krahët e ngrohta”, pasi kanë fituar besimin e shefit, prandaj edhe deklarohen se janë të gatshëm të bëjnë çdo detyrë dhe të ndihmojnë në përmirësimin (shkatërrimin) e punës në institucion, administratë apo ndërmarrje, ata nuk bëjnë pjesë në grupin e vlerësimeve të Sokratit të madh për njeriun e punës, të urtë dhe kokulur, që kërkon çdo ditë të rrisë nivelin e kulturës dhe të formimit, që gjithnjë deklarohej për veten e tij se “Unë di një gjë, që nuk di asgjë!” Mesazhi është i qartë: vetëm budallai i di të gjitha!

Ndodh që ky individ “ushqen” shefin çdo ditë me të rejat nga thashethemnat e qytetit, të cilat në kulturat dhe subkulturat e vogla, janë të shumta, shpeshherë edhe të sajuara. Servilët dëgjojnë e konfirmojnë për lëvizje nga puna të njërit apo tjetrit, propozojnë dhe i “japin mend” shefit, bëjnë shkarkime e lirime nga detyra, hartojnë edhe listat “e të aftëve”, që do të zëvendësojnë “të paaftët”!

Me tipa të tillë nuk ke mundësi të bësh një bisedë të thjeshtë, pasi kthehesh me trastë fjalësh dhe transmetim të tyre, edhe në mënyrë të deformuar për njërin apo tjetrin, mjafton që ata të gjejnë rehati te padroni i tyre, të ndihen mirë, si njeriu më i afërt i titullarit të institucionit. Nga mënyra e funksionimit të këtij mekanizmi të pamoralshëm, më të rrisuar janë personat e administratës ose të institucionit, që nuk e kanë mirë me shefin. Këtë e di mirë servili, pasi ka përvojë në këtë “zanat”. Rrjedhimisht, ndodh që njerëz të ndershëm dhe të aftë spostohej nga detyra që u takon, mundet edhe lançohen, pasi shefi ka marrë informacion joreal përmes “sekretarit” të tij. Krijohen në rrethana të tilla vlerësime subjektive për njërin apo tjetrin, meritat materiale dhe shpeshherë edhe ato morale merren nga dembelët, servilët, që nuk i ka vlerësuar kush për punë përgjatë viteve, por që dinë të sillen me shefat, t’i informojnë ata për “bëmat” e këtij apo atij personi, që është larg me bindje dhe me mendime nga shefi i tij, që nuk është konformist. Fatkeqësisht,

edhe sot vazhdojnë që njerëz të tillë të vlerësohen për merita të pamerituara. Me të tilla sjellje e vlerësime “...ku motivohen servilët dhe të korruptuarit, partiakët dhe njerëzit që kanë afri gjaku me pushtetarët dhe politikanët, por që nuk e meritojnë, shoqëria nuk e kalon cakun e pluralizmit, kultura nuk zhvillohet dhe demokracia nuk ndërtohet.”⁶³

Largimi nga vendi i punës i njërit apo tjetrit drejtor apo shef, kushdo qoftë ai, është një gjë normale, pasi, në ndryshim nga sistemi komunist rrënimtar, në sistemin demokratik lëvizjet janë të shumta dhe të shpeshta jo vetëm kur humbet zgjedhjet forca politike që përfaqëson, por edhe kur ajo i ka fituar ato. E keqja është ndryshimi njëqind për qind i sjelljes dhe i qëndrimit ndaj teje nga sekretari yt (nënkupto: servili). “Tashmë nuk je më shefi im”, mendon dhe vepron servili. “Duhet t’i rri sa më afër shefit të ri, t’i fitoj zemrën, t’i jap informacion “të saktë” për zonën e institucionin, rrethin apo qytetin e rajonin, pasi ai nuk e njeh atë”! Mendja e tij tashmë punon vetëm për titullarin e ri, kujdeset në detaje për të dhe familjen e tij. Si të thuash, vihet tërësisht nën komandën e tij. E pësthirë, por ky është një realitet që duhet ta pranojmë të gjithë, me përjashtim të atyre që vuajnë nga virusi i servilizmit. I shohim dhe i dëgjojmë të tillë individë.

Kur shefit “i rrëshqet këmba”, servili nuk shqetësohet më për atë, nuk do t’ia dijë për të dhe as për familjen e tij. Jo vetëm kaq, por i shmanget rrugës kur e sheh, pasi ka frikë se i prishet imazhi, po e pa shefi i ri. Mundet, punon edhe kundër ishrit, flet edhe keq për të. E turpshme! Shumë e turpshme! Oh, sa shumë kam parë të tillë jo vetëm ndaj personit tim, por edhe ndaj të tjerëve, personalitete të kulturës, të politikës dhe më gjerë!

Shefi i mirë, me të cilin t’i krenoheshe deri dje, u bë sot keq, jo aq i saktë dhe organizator sa ky i riu! Dje ti kërkoje me çdo mënyrë të ishe në krahët e tij, sakrifikoje për të, përbetoheshe për mirësitë dhe cilësitë e tij pozitive, u bëje karshillëk të gjithëve tek i shkoje prapa, e qerasje përditë dhe ndërhyje orë e çast duke dhënë konsiderata për njërin apo tjetrin person. Natyrisht, si të pëlqenin ty dhe në mënyrë subjektive. Me të vetmin synim: Të përfitoje ti dhe njerëzit e tu duke mos u lodhur dhe pa e merituar

63 Dushku, Qazim: “Motivimi”, Enti botues poligrafik “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2000, fq. 38

fare. Sepse po të kishin merita, është një e keqe jo e domosdoshme, por disi e pranueshme për kohën që po kalojmë.

Pas largimit të shefit, servili mendon ndryshe, e vret mendjen për të gjetur atë që vjen, mendon dhe ndjek rrugë e forma nga më të turpshmet për të fituar sa më shpejt besimin tek ai. Psikologjia e tij është vetëm rehatia dhe fitimi, vetëm bashkimi me fitimtarin, me të fortin! Të tjerët, duke përfshirë edhe ishin e tij, nuk i interesojnë më. Për këtë, ai krijon skenar të ri për t'u konfirmuar "i aftë edhe me fitimtarin". Ai u ngjan personazheve të librave të shkrymtarëve të njohur të shekullit të kaluar dhe më tej. Për servilët e këtij formati, cinikë dhe të pabesë, mashtrues dhe koprracë me të tjerët, por jo me drejtorin apo kryetarin aktual, dinjiteti i humbur nuk ka asnjë vlerë, mjafton të jetë kurdoherë me fituesin, t'u mbijetojë të gjitha opsioneve politike, pavarësisht nga ngjyra. Për tipa të tillë "*...vetëm një gjë ka rëndësi: të jetë gjithmonë me anën e fitimtarit, jo në anën e të mundurve.*"⁶⁴

Pothuajse asgjë nuk ka ndryshuar te servilët e kohës moderne nga ato të klasikes. Me një të kërcyer, tipa të tillë kalojnë në kampin kundërshtar, që deri dje nuk i përkisnin atij. Në sajë të dinakërisë së tij dhe të karakterit të deformuar deri në maksimum, në sajë të dyfytërisë, dyzimit të personalitetit dhe të njeriut pa asnjë kod moral, ai arrin t'u mbijetojë të gjitha kohërave, të përballojë të gjitha furtunat, pavarësisht nga kostoja, të gjitha sfidat, sado të vështira të jenë ato. Nuk i intereson fare morali. Përkundrazi, duke qenë amoral dhe cinik, ai nuk i shërben kurrë një ideje, por gjithmonë vetëm e vetëm pushtetit, duke i tradhtuar të gjithë në çastin më të volitshëm. Servili e nuhat se kush do të fitojë, sipas tij, në përplasjet mes dy formave të qeverisjes, mes dy kandidatëve për kryetar apo shef. Gjykon se cili prej tyre është më i fortë dhe ka më shumë politikë, cili ka më shumë mbështetje nga udhëheqësia e kohës. Ai mendon se "*...prapë, kur ndryshojnë situatat, (shënimi im, Q.D.) duhet marrë ana e dikujt, por ai s'para ka qejf ta lidhë veten përpara se përcaktimi i pozicioneve të bëhet i sigurt dhe me leverdi...*"⁶⁵

Servili synon të bëhet me këdo, me çdo lloj grupimi dhe partie.

64 Stefan Cvajg : "Zhoze Fushe, T. 1992, fq. 3

65 Cvajg, po aty, fq. 29

Ai nuk rrezikon kurrë të bëhet me partinë e pakicës, me partinë pa leverdi. Kështu është gatuar ai. Shoqëria vetëm e kritikon, por asnjëherë nuk e anatemon.

Ai vazhdon zanatin e rij mashtrues dhe hipokrit. Duke qenë i tillë, është i pabesë dhe tinëzar. Pret momentin të japë një mendim ose opinion për shefin e tij në një bisedë të lirë mes shokëve dhe shumë shpejt i përcjell te zotnia i tij. I çon fjalët të deformatuara dhe të interpretuara sipas oreksit dhe interesave të tij, për t'u bërë "më i nevojshëm" për drejtorin apo kryetarin, për të krijuar njëfarë besimi tek ai dhe për t'i thënë atij se "unë (servili yt) jam i domosdoshëm për ty, prandaj më vlerëso dhe më dëgjo kur jap konsiderata (jo) reale për njërin apo tjetrin punonjës ose vartës!" Unë dua, mendon servili, që ti, shefi im, të ndihesh sa më mirë në punë, t'i njohësh sa më mirë punonjësit që ta duan të keqen dhe që përpiqen të ulin imazhin e mirë që ke në komunitet, në ndërmarrje ose në institucion. Natyrisht, sipas mënyrës së njohjes që ka për njerëzit, servili ndjek rrugën selektive, duke i ndarë bashkëbiseduesit në dy grupe, në ata që flasin mirë dhe e duan shefin dhe në ata që nuk e duan dhe nuk e vlerësojnë atë. Sigurisht, duke ndjekur parimin e tij amoral: kush i bën temena shefit, është i aftë, i mirë, i zoti!

Të tjerët, që nuk e bëjnë një gjë të tillë, mundet edhe ta kritikojnë drejtorin për të meta e dobësi në punë, që bëjnë edhe sugjerime për metodën e drejtimit dhe të vlerësimit të grupit dhe që mund të japin edhe opsionet e veta për ta përmirësuar sistemin e drejtimit, janë njerëz të ligj, cinikë dhe karrieristë! Sipas vlerësimit të servilit, ata luftojnë t'i zënë vendin atij, pasi janë edhe ziliqarë, edhe të paaftë!

Sikur egoja për karrierë dhe përpjekjet të mbështeteshin në dijet shkencore dhe aftësitë profesionale, në trajnimin permanent dhe në njohuritë që ai ka për punën dhe institucionin ose në administratë, qëllimi për çfarë lufton ai, servili, është i pranueshëm. E keqja është kur "meritat dhe aftësitë" për dikë dhe për mundësinë e kryerjes së një pune prej tij serviren nga të tjerët. Ndodh që inspirohen edhe nga vetë personi, ia bën, siç thotë populli, me sy vetes, për arritjen e synimeve të tilla, paçka se ai ose ajo vuan nga inferioriteti intelektual, kulturor e profesional dhe nga mungesa e kontributeve në fushën e tij të

punës. Të tillë kandidatë “të përgatitur dhe me përvojë” i ofron servili, por edhe partia në pushtet, shefit të tij për punë më të zgjedhura. E njëjta praktikë ndiqet nga të tillë “kuadro” edhe në linjë vertikale. Ec pastaj e zhvilloje arsimin dhe kulturën me forma të tilla të njohjes dhe të vlerësimit të njerëzve për punën!

2. Profile servilësh

Servilët janë të llojeve dhe të formateve të ndryshme. Paraqiten edhe me kostum e kollare. Ka edhe të tjerë që nuk mbahen mirë. Ata i gjen në institucione, në komunitet, në administratë publike, në sektorin privat dhe atë shtetëror. Nuk janë faktorët ekonomikë që e kanë bërë atë servil, ndonëse duhet pranuar se edhe varfëria ka peshën e saj në deformimin e karakterit të njerëzve, në dyzimin e personalitetit të tyre, në shprishjen e karakterit dhe të botës së tyre emocionale me elemente negative, që e bjerrin dinjitetin e tyre, e gërryejnë nga brenda dhe e bëjnë person të papërshtatshëm dhe të padëshirueshëm në rrethin shoqëror dhe në mjedisin ku ai punon dhe jeton.

Pavarësisht nga lidhja që ka binomi servil – varfëri, problemi nuk duhet përgjithësuar, pasi njohim me dhjetëra njerëz që kanë vështirësi të mëdha ekonomike, që rropaten ditën dhe natën për të siguruar bukën e gojës pa iu nënshtruar askujt, pa u bërë bartës të thashethemeve dhe fjalëve të paqena, ose të thëna, që nuk pranojnë të luajnë rolin e servilit për t’u hyrë në qejf “të mëdhenjve”, autoriteteve zyrtare, të cilët të kanë në dorë ty dhe familjen tënde. Duke paragjykuar, ose duke e dëgjuar servilin e tij sekser, mundet që të tillë “intelektualë” veprojnë si anadollakë e sharlatanë, ndodh që, po nuk e pate mirë me njeriun e tij “të afërt” (nënkupto servilin e tij), të largon edhe nga puna dhe të bën të vuash. Ka edhe të shkolluar dhe intelektualë, punonjës të administratës dhe të institucioneve që nuk e pranojnë dyzimin, që kanë pështirë dhe ndiejnë keqardhje për shokun e tyre të jetës ose edhe të punës, kur ai është shfaqur tinëzar dhe cinik me ty, në moment kthesash dhe vështirësish.

Ja disa nga tipat më përgjithësues, sipas meje, të servilit dhe të servilizmit. Ka nga ata që shfaqen si të tillë haptazi, ka edhe nga ata që janë më të fshehur. Profilet e servilëve që po të sjellim, nuk janë hipotetikë, por realë.

Rasti i parë: Je drejtues në nivel të mesëm në një institucion edukimi. Mundet edhe në një universitet. Ke vite mbi shpinë, natyrisht edhe kontribute. Koha dhe brezat do t'i vlerësojnë ato. Për ty, në moshën që ke ka përfunduar karriera, nuk ke më perspektivë për t'u joshur pas saj. Mjafton që të merresh me studime dhe të rritësh cilësinë e punës si pedagog, me apo pa titull dhe e ke në proces përfundimi misionin tënd. Rruga nuk është më e hapur për ty, por për brezat që vijnë. Aq më tepër në moshë të madhe (mundet t'i kesh kaluar të 70-tat) nuk ke arsye të luftosh për karrierë, nuk ke shkak për t'u konformuar, për t'u shpërfillur si njeri, si intelektual. Mirëpo ja që ndodh, ti nuk lë gurë pa lëvizur, mik e shok pa kapur për ta rregulluar me shefin që në një moment të ngjitesh shkallët e karrierës, paçka se të kanë mbetur pak vite nga jeta. Së paku duke u nisur nga mosha që ke. Në përpjekjet e tua për karrierë, miraton çdo mendim të drejtorit, shefit, ministrit tënd, paçka se ato mund të jenë të gabuara dhe mund të mos i vlejné politikës së institucionit, arritjes së objektivave që ai ka. Jo vetëm ndaj shefit tënd të madh, por edhe punonjësve të thjeshtë pa asnjë vlerë morale e intelektuale, por që ti mendon se diçka ka në dorë për ty, fillon e ndryshon sjelljen, konformohesh edhe me atë, të paditurin, të pashkolluarin. Turp, njëmijë herë turp! Kështu ti zhvlerësohesh, birresh, tjetërsohesh si njeri. Siç duket, kështu ke qenë edhe në rininë tënde, edhe në moshën e rritur. Metamorfoza nuk ndodh sa hap e mbyll sytë.

Për shërbime të tilla servile, që të duken haptazi, mundet që ti merr edhe një pozicion vërtet të rëndësishëm, paçka se në kolektivin me të cilin ti punon dhe më gjerë ta bëjnë me gisht, të njohin si njeri pa personalitet, si servil dhe ndoshta edhe më tepër. Tashmë në pozita të tjera drejtuese, natyrisht më të larta, ti bëhesh edhe më hipokrit, më servil, më i pabesueshëm. Tashmë për ty shefi i madh është perëndia. Je në shërbim të tij, paçka se ju mund të keni diferencë të madhe në moshë me njëri-tjetrin. Ti kryen veprime e sjellje vërtet të pështira, që shprehin hapur karakterin tënd të dobët. Ndodh, që vrapon si djalosh i ri me çadër në dorë për t'ia dhënë shefit që po vjen drejt teje, pasi ai po laget se nuk ka mjet të tillë mbrojtës nga shiu për momentin. Ti ndihesh edhe më i ofenduar kur shefi yt nuk ta pranon një sjellje të tillë, nuk e honeps servilizmin tënd, nuk ta pranon shërbimin

që ti përpiqesh t'i bësh. Nuk ka poshtërim më të madh për ty, udhëheqësi i moshës së tretë, sesa qëndrimi i eprorit tënd ndaj teje në këtë rast.

Rasti i dytë: Ke vendosur të rriskosh duke u marrë me politikë. Në kuptimin që do ta pranosh jetën tënde të survejuar nga gazetarët dhe paparacët. Nga ata që të duan, por edhe nga të tjerë që nuk kanë simpati për ty. Përpiqen të zhbirilojnë në jetën tënde private e familjare. Jo thjesht për lajm, por edhe për të qenë ata më të pranueshëm dhe më të vlerësuar nga padronët e tyre, qoftë ky privat apo shtetëror.

Nuk është ndonjë situatë e pëlqyer të qenët politikan. Së paku kështu mendoj unë, ndoshta nga fakti se gjithë jetën ia kam kushtuar dhe do të vazhdoj t'ia përkushtoj arsimit dhe edukimit. Të tjerët mund të kenë mendime të ndryshme nga unë. Është e drejta e tyre. Dhe e lidhin këtë me favorët e mëdha që përfiton politikan. Së paku kështu thuhet e flitet, shkruhet e deklarohet nëpër gazeta dhe në tërësi në media. Le t'i referohemi të qenit deputet, që, siç kam dëgjuar e parë nga miqtë e mi, ka jo pak gjëra në dorë. Sidomos në kushtet e një demokracisë të turbullt, siç është vendi ynë.

Deputeti të ndihmon për të gjetur një punë të mirë ty dhe familjes sate, të mbështet dhe të mbron kur të tjerët të sulmojnë për motive nga më të ndryshme, të siguron lehtësira në udhëtimet jashtë shtetit për vizita pune apo edhe private, për turizëm etj. Je kështu një person publik, i njohur nga të gjithë. Duam ta pranojmë apo jo, ta kanë nevojën të gjithë. Së paku edhe për disa vite, derisa secili të bëjë punën e vet.

Pas një pune të lodhshme, aspak për t'u pasur zili, aq më tepër kur je bërë deputet, ose je bërë kryetar bashkie apo komune, të lodhin "shokët" dhe "miqtë". Ata "të duan" të gjithë! Në pozitat e deputetit, numri i atyre që flasin me superlativa rritet. Disa prej tyre deklarohen si pararojë e udhëheqjes së votuesve në fitoren e tij, paçka se edhe ata vetë mund të mos kenë votuar për deputetin. Mundet që "kontribuuesit" bëhen shumë të bezdisshëm për deputetin që ka fituar. Dhe jo vetëm ata. Turma është aq e madhe sa të krijohet përshtypja se rrethi i shoqërisë dhe i miqve të politikanit është shumë i madh. Janë edhe ata që mund të kenë punuar edhe kundër tij në fshehtësi, kanë qëndruar

disi indiferentë gjatë fushatës ose kanë votuar për të, por që nuk kanë asnjë ndikim në elektorat për të bërë për vete sa më shumë votues në favor të kandidatit.

Këta lloj tipash pa personalitet dhe me integritet moral të dyshimtë, tashmë e shoqërojnë deputetin vend e pa vend. I japin edhe këshilla në qëndrimet e tij selektive ndaj njerëzve, “e ushqejnë vazhdimisht me informacion real” për problemet e komunitetit apo të zonës, të mënyrës së funksionimit të institucioneve në nivel lokal dhe rajonal, bëjnë edhe biografinë e të tjerëve, kanë kurajë t’i japin atij edhe sugjerime se si duhen ndërtuar marrëdhëniet dhe mënyra e sjelljes me këtë apo atë person. Gjithë ditën i shkojnë atij mbrapa, aq sa ty, drejtuesit të një institucioni të rëndësishëm, nuk të krijohet mundësia të rrish vetëm me deputetin, qoftë edhe për disa minuta, për të diskutuar për një problem pune shtetërore. Servilët e vlerësojnë shumë atë, e ftojnë përditë për dreka e darka dhe i shërbejnë edhe familjes së tij. Pse jo edhe të afërmve të tij.

Elozhet për deputetin e tyre janë aq të mëdha dhe deklaratat në mbështetje të tij dhe të punës së mirë që bën janë aq të shumta nga njerëz të tillë të pamoralshëm, sa politikani joshet deri në atë masë sa nuk e kupton se shumë prej tyre ia kanë me hile. Njëherazi të krijohet përshtypja se ky lloj politikani do të jetë i përherëshëm, pasi do të ketë mbështetje të fuqishme, sidomos nga ata që kanë përfituar më shumë dhe që nuk e kanë lënë rehat të kalojë disi në qetësi edhe pushimet.

Mirëpo në politikë situatat ndryshojnë shpesh dhe shpejt. Në këto rrethana, deputeti i suksesshëm, për arsye nga më ndryshme, nuk zgjidhet më kandidat. Janë gjëra që ndodhin dhe që duhen pranuar me qetësi dhe pa ngarkesë të madhe emocionale, pasi emocionet e pafuqishme dhe të pakontrolluara të çojnë në qëndrime e sjellje devijante dhe aspak normale, në mënyra komunikimi jocivile.

Shqetësimi nuk lidhet pse ish-deputeti nuk u zgjodh më. Ai lidhet me ndryshimet e sjelljes dhe të qëndrimeve të të tjerëve ndaj ish-it të tyre. Tashmë atë e lënë rehat, zilja e telefonit nuk i bie më, drekat e darkat nuk ekzistojnë më, me përjashtim të miqve dhe shokëve që ai i ka pa asnjë interes. Turma e njerëzve, që e shoqëronin politikanin e tyre, kur ai ishte në pushtet, “që e

donin dhe e vlerësonin aq shumë”, tashmë është zhdukur, ajo i është larguar atij.

Raste të tilla analoge si ky ka mjaft. Kushdo që ka punuar dhe punon në drejtim, mund të sjellë profile të tilla servilësh e pse jo edhe spiunësh. Kur ke pushtet, ke shumë njerëz që të duken se i ke miq me të cilët mund të ndash kohën, por shumë pak të tillë me të cilët mund të ndash zemrën, sepse *“Miqtë janë si puna e pjeprit. Pse? Sepse për të gjetur një të mirë, duhet të kërkosh qindra”*.⁶⁶

Letërsia, sidomos ajo artistike, na jep shumë shembuj individësh të rrethuar nga hipokrizia dhe dyfytërsia, të veshur bukur artistikisht dhe me cilësitë dalluese të tyre, atë të servilit dhe të cinikut. Jago, personazhi i veprave të Shekspir të madh, është në të vërtetë simboli i njeriut me dy faqe, servil dhe njeri shpirtlig. Në personin e tij si zor të gjesh një grimcë të njeriut me njëfarë mirësie. *“...ai është i tëri, kokë e këmbë – ligësi. Mjeshtër intrigash, hipokrit si ai, shpifës dinak, lavdërues e servil marramendës, i zgjuar dhe i zoti për të thurur sherre e komplote, i pangopur për të bërë keq, kur duhet yshtës e fjalëmbël. Shtoni vetë çfarë të doni e sa të doni atributesh të kësaj natyre dhe mos keni frikë se e teproni.”* (Beqja, Hamit: Edhe engjëlli edhe djalli janë brenda tek i gjalli, Shtëpia Botuese “Albinform”, T. 1995, fq. 154).

Edhe Zhosefi i Cvajgut është personifikimi i njeriu të ulët, me moral të deformuar dhe intrigues, njeri që transformohet e tjetërsohet në vartësi të kushteve dhe rrethanave që i leverdisin atij në tërësi dhe karrierës në veçanti, cinik i paparë, njeri që ka humbur çdo ndjenjë njerëzore, duke përfshirë edhe atë ndaj prindërve. Edhe për këtë personazh mund të thuash ç’të duash dhe nuk i ke shtuar asgjë, përveç se ia pasuron karakterin me të liga të vërteta. Ai paraqitet, sipas situatave që i interesojnë, edhe radikal, edhe kameleon, edhe servil, edhe lajkatar disi i veçantë, edhe renegat e dezertor, por edhe manipulator, edhe nuhatës i kthesave, edhe njeri i pazareve, tradhtar i shokëve dhe i idealeve.

Në luftën mes radikalëve (midis Dantonit dhe Robespjerit, midis Heberit dhe Dëmulënit) *“... prapë duhej marrë ana e dikujt, por Fusheja s’para ka qejf ta lidhë veten përpara se përcaktimi i pozicioneve të bëhet i sigurt dhe me leverdi. Ai e di se zgjuarsia e diplomatit qëndron në atë që, në momentin e vendin e duhur, duhet të*

jesh sa më larg disa ngjarjeve. Kështu vendos ta braktisë arenën politike të Konventës për sa kohë të vazhdojë lufta për t'u kthyer sërish kur konflikti të jetë zgjidhur...Kur të kthehet ai, çështja e luftës do të jetë zgjidhur dhe ai do të mund të bashkohet i qetë e i sigurt me fituesin, me partinë e tij të përjetshme, me shumicën.”⁶⁷

Ky është personazhi i ndërrimit të lëkurës sa herë ia do interesi. Para interesit, lavdisë dhe fitimit fushetë e këtij tipi nuk ndalen, por intrigojnë, kurdisin prapaskaena dhe punë të liga.

Në realitetin tonë dallohen, kryesisht, dy tipa servilësh. Ata që shfaqen hapur dhe duken ashiqare, siç thuhet, dhe ata që veprojnë me dinakëri dhe prapa kulisave, që përpiqen të mos e shfaqin servilizmin e tyre tek opinionin në tërësi dhe në komunitetin që ata e njohin. Këta të fundit janë më të rrezikshëm, pasi lajkat e tyre ndaj teje si shef, në tërësi janë të shtirura dhe dyfaqësore. Duan ta kenë mirë me të gjithë shefat, jo thjesht në kuptimin për të qenë rehat, por edhe për të përfituar sa më shumë. Sigurisht, pa punuar dhe pa e merituar. Si rregull, ky lloj servil nuk njih as normë morale dhe as kod etik, as moral dhe as shoqëri e miqësi. Paraqitet e shitet në opinion si parimor dhe i emancipuar, si i ditur dhe i kulturuar, disi edhe më shumë se të tjerët, si i qytetëruar dhe bashkëpunues, si mbrojtës i interesave të qytetarëve dhe i të drejtave të njeriut. Fjala është për servilët e shkolluar, të formuar keq dhe që kërkojnë të bëjnë shpesh herë dhe shumë herë karrierë jo aq të merituar dhe në kurriz të shoqërisë. Në shumë raste, ata janë edhe të paaftë dhe krijojnë situata aspak mobilizuese e motivuese në punën që janë ngarkuar të bëjnë. Në këto kushte e rrethana krijohet natyrshëm te qytetarët e thjeshtë perceptimi i gabuar për demokracinë, pasi ata shohin dhe përballen çdo ditë edhe me zyrtarë të paaftë, mediokër, tinëzarë dhe servilë.

3. Disa mendime për rrezikshmërinë shoqërore të servilëve

Servilizmi dhe bartësit e tij janë fatkeq. Njerëzve të ndershëm dhe të moralshëm u vjen keq për servilët, kur i shohin tërë ditën pas politikanëve dhe pushtetarëve aktualë dhe kur ata “ua rrisin vlerat” atyre, vlera që ndoshta drejtorët apo shefat nuk i

67 Stefan Cvajg, Zhoze Fushe, T. 1992, fq. 29 – 30

meritojnë. Këtë e di edhe servili vetë, pasi ai shkëputet menjëherë prej tij sapo atë e lëvizin. Servili është nuhatës i mirë i situatave, pasi mendja e tij punon vetëm për përfitime pa kokëçarje, pa u lodhur, pavarësisht se mund të mos ketë asnjë meritë profesionale dhe sociale.

Bartësit e servilizmit janë jo vetëm të paaftë dhe tinëzarë, por edhe konformistë, pasi duan ta kenë mirë me të gjithë. Natyrisht me ata që kanë, sipas psikologjisë së tij, diçka në dorë. Ata kthehen në bartës të fjalëve dhe të sajësave. Për të fituar besueshmërinë e shefit, ndjekin parimin “përça dhe sundo”. Në këtë kuptim, ata paraqesin rrezikshmëri për shoqërinë dhe demokracinë për disa arsye:

Së pari, servili, duke qenë shpeshherë i paaftë dhe me formim gjysmë të cunguar, kultivon në administratë dembelizmin dhe parazitizmin. I bën dëm të madh punës, por edhe vetë politikanit ose pushtetarit, që e pranon çdo ditë atë vend e pavend dhe kohë e pakohë. Shoqërimi me shefin për servilin është vlerësim, ndërsa për vetë drejtorin apo politikanin është zhvlerësues. Servilët kultivojnë mendimin se edhe sot, kur flitet për alternativë dhe konkurrencë idesh, për treg pune dhe për ekonomi tregu në tërësi, mund të jesh i paaftë, por mund të strehohesh diku në një punë të mirë dhe me përfitim. Natyrisht për sa kohë e ke shefin në detyrë. Mund të bësh edhe karrierë të pamerituar, çka i sjell dëme të mëdha ekonomisë dhe kulturës në tërësi.

Historia e Shqipërisë në shekullin e 20-të dhe të 21-të ka treguar se në një masë të konsiderueshme, në poste të ndryshme drejtuese, janë vënë shpeshherë njerëz me kufizime intelektuale dhe jo vetëm, të pavullnetshëm për punë dhe me kulturë të cunguar. Duke qenë edhe servilë të udhëheqësisë dhe drejtuesve të tyre, ata bënin edhe karrierë, çorganizonin punën e shtetit, ofronin rreth vetes të tjerë mediokër dhe servilë, duke ushqyer edhe më shumë dembelizmin dhe paaftësinë.

Poeti kombëtar Gjergj Fishta, me humorin e tij të hollë dhe me figuracion letrar të pasur, ka ditur të anatemojë praktika të tilla pune, që nënvlerësonin intelektualin e vërtetë, njeriun e punës dhe të ndershëm dhe u jepnin krahë servilëve të kohës, njerëzve pa asnjë meritë, pa asnjë kontribut dhe njohje për sektorin e fushën që mbulonin, të cilët, të veshur bukur artistikisht nga ai,

i vinte ata në lojë me atë sarkazmin e tij therëse e shpotitëse. Më bukur se kudo, poeti ia ka dalë mbanë kësaj me poemën e tij të njohur “Gomari i Babatasit”, përmes vargjeve:

*Udha e mbarë, e t'u ngjat jeta!⁶⁸
Mbasi sod asht dit pazari,
Po e qes n'treg at zog gomarit
Qi paç ble për pun t'Muzeut,
“Për lulzim e nder t'Atdheut”
Pale i her a e blen ndokush.
Mana, drue se s'do t'dal kush
Myshteri, pse Barbullush
Asht ba sod edhe Tirana.*

Edhe përgjatë viteve të socializmit specifik shqiptar, ku prona ishte e të gjithëve dhe e askujt, ku bota shpirtërore e njeriut u denatyralizua dhe gjendja e tij psikologjike u shkatërrua, në shumë raste roli i drejtuesit i besohej të pashkolluarit, me gjysmë formimi arsimor dhe në pjesën më të madhe të tyre ata ishin të bindur verbërisht ndaj urdhrave të partisë shtet dhe partiakëve në tërësi. Në ato vite qarkullonin shumë anekdota dhe flitej shumë për budallallëqet në drejtim të mjaft “kuadrove”, që nuk dinin as të lexonin mirë, e shkruanin dhe e flisnin gjuhën shqipe me mjaft të meta e gabime morfologjike e sintaksore. Kushdo nga ne sjell realitete të asaj kohe, ku drejtimi ishte “i kualifikuar”. E njëjta situatë, në mos më keq, paraqitet gjendja edhe sot, ku në mjaft sektorë e punë të rëndësishme drejtojnë të paaftët, servilët e partisë. Shembuj nga injoranca edhe në ditët tona të disa drejtuesve janë jo të pakët. Ndoshta kjo do të jetë objekt i ndonjë shkrimi tjetër në të ardhmen.

Së dyti, servilët krijojnë atmosferë të pakëndshme në grupin ku ata punojnë, pasi në njëfarë mënyre ai luan edhe rolin e spiunit. Imagjinoni sa pasoja ka për formimin dhe edukimin e rinisë, kur brenda kolektivit ndodhet një servil i hapur, fjala vjen, ndaj drejtorit të shkollës ose të një institucioni tjetër. Ai luan rolin

68 Fishta, Gjergj: “Gomari i Babatasit”, Shtëpia Botuese “Hylli i Dritës”, T. 1994, fq. 79

e informatorit, thith me shpejtësi e vëmendje të përqendruar çdo fjalë që thuhet për drejtuesin e tij, qofshin ato të mira apo të këqija. Kjo çon në prishjen e humorit, për të cilin edhe mësuesit e pedagogët në kohën dhe momentin e caktuar kanë shumë nevojë. Përçahet kolektivi, krijohet klimë mosbesimi e ndërsjellë, bie niveli i komunikimit ndërpersonal dhe ndërgrupor, pushojnë diskutimet dhe debatet kur është i pranishëm ai, servili dhe spiuni, pasi ai mund të ketë lidhje me një tjetër servil.

Rrethana të tilla krijojnë pakënaqësi dhe fusin frymën e grupazhit, çojnë në dobësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies dhe, për rrjedhojë, marrëdhëniet mes individëve dhe palëve acarohen.

Dukuria mund të shmanget dhe klima në një kolektiv bëhet e këndshme vetëm kur drejtori dhe drejtuesit në tërësi nuk do të pranojnë "asnjë informacion" të kujtdo servili. Ai vetë, nëse është i aftë dhe dëshiron t'i shkojnë punët mirë në kolektiv, duhet t'i njohë njerëzit përreth tij dhe vetëm në punë e sipër.

Së treti, drejtuesi servil, shpreh ndër të tjera jo vetëm paaftësi, por edhe prepotencë ndaj vartësve, pasi i mungon forca e argumentit, aftësia për të menduar e gjykuar kur është fjala për t'u dhënë zgjidhje problemeve të shumta që nxjerr jeta e përditshme në punë. Ngaqë intelektualisht dhe moralisht ndihet inferior ndaj të tjerëve, nuk merr përsipër detyra e përgjegjësi, për shkakun e thjeshtë se nuk di, por edhe për arsye se e ka mburojë shefin, me të cilin komunikon hera-herës. Edhe nëse ka iniciativë për të marrë përsipër një detyrë ose për të zgjidhur një problem pune, nuk mundet ta bëjë, pasi është i varur nga shefi ose zgjidhja e problemit bëhet me të meta.

Servilët dhe të paaftët nuk mund të dalin mbi mosmarrëveshjet dhe konfliktet, që gjenerojnë vazhdimisht në institucione dhe natyrisht nuk mund t'u japin atyre zgjidhje.

Për interesat e veta mesquine dhe për paaftësi, servilët kërkojnë ta kenë mirë me të gjitha grupet, pasi situatat mund të ndryshojnë. Ata janë me të gjithë dhe kundër të gjithëve. Nuk duan kokëçarje, duan të dinë çdo gjë që flitet e thuhet në ndërmarrje apo në institucion, merren me fjalë e transferim të tyre, duke i deformuar shpeshherë ato, çka është me rrjedhoja negative për grupin dhe punën e tij.

Për këto e të tjera arsye, servilët janë të rrezikshëm për shoqërinë në tërësi dhe individin në veçanti. Ata janë miqtë e tu vetëm kur ke pozitë, kur ke diçka në dorë. Me t'u larguar nga karrigia, shfaqen mosmirënjohës dhe e ndërrojnë pllakën nga ana e tjetrit, e atij që është veshur tashti me pushtet. Në këto kushte, ata duhen njohur dhe pastaj injoruar. Ata nuk duhen dëgjuar dhe as përfillur. Për më tepër, atyre nuk u duhet marrë asnjë mendim në konsideratë, asnjë opinion. Nëse sillemi e veprimë ndryshe, intelektualit dhe politikani, kushdo qoftë ai, birret, humbet diçka në vlerat e tij. Prandaj sa më larg servilëve.